



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

TREGUESIT STATISTIKORË TË SHËRBIMEVE POSTARE

Viti 2018



I. HYRJJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për vitin 2018, i cili publikohet në faqen e Internetit të AKEP-www.akep.al, në seksionin “Statistika”.

Për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, jo të gjithë treguesit e raportuar nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare publikohen nga AKEP.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për vitin 2018 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (14 subjekte):**
 1. Albanian Cargo Service sh.p.k (A.C.S);
 2. Albanian Courier sh.p.k (A.C);
 3. Albanian Delivery Express sh.p.k (ADEx);
 4. DHL International (Albania) sh.p.k;
 5. RAD MAIL sh.p.k;
 6. Sky Net Logistic sh.p.k;
 7. TNT Express Albania sh.p.k;
 8. Ulysses Enterprises sh.p.k (Fedex);
 9. United Transport sh.p.k (Uni Trans);
 10. Youth Albania Professional Services (YAPS);
 11. Fast-Delivery sh.p.k;
 12. E-KOMPLET sh.p.k;
 13. COEX shpk;
 14. Albanian Parcel Distribution shpk.

AKEP, për subjektet e sipërcituar:

- Në mbështetje të nenit 64 pika 3 e ligjit 46/2015, me Vendimin Nr.2581, datë 22.06. 2015 ka pajisur Posta Shqiptare sh.a., me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjecar.
- Në zbatim të Ligjit Nr.46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Rregullores nr. 38, datë 19/11/2015, “Për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare, subjektet e sipërcituar janë pajisur nga AKEP me Certifikatë të

Konfirmimit të Njoftimit për ofrimin e shërbimeve postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit dhe evidenca e realizimit të shërbimeve postare;
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimeve ekspres/jo universale;
4. Treguesit teknik dhe të rrjetit;
5. Cilësia / Standardet e realizimit të shërbimeve postare;
6. Të punësuarit;
7. Ankesat e përdoruesve (Reklamacionet);
8. Të ardhurat financiare nga shërbimet postare.

Posta Shqiptare, si ofrues i shërbimit universal postar ka plotësuar Formularin A me të dhënat statistikore postare respektivisht të përcaktuara nga pika A deri në pikën H, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë plotësuar Formularin C me të dhënat statistikore postare respektivisht të përcaktuara nga A deri në pikën G.

IV. TRAJTIMI DHE PARAQITJA E TË DHËNAVE

Të dhënat e dërguara dhe të trajtuara në këtë raport jepen për zërat kryesorë të shërbimeve postare, në të cilat përfshihen nënzërat e tyre.

Paraqitja e të dhënave është bërë në mënyrë tabelare dhe grafike duke ju referuar të dhënave për objektet postare të pranuar si dhe krahasimi me vitet e paraardhëse.

1. Të dhëna përmbledhëse të shërbimeve postare

Gjatë vitit 2018 rezultojnë 25,413,916 objekte postare të pranuar nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare:

Tabela 1- Të dhëna mbi kategorite kryesore të objekteve postare (2017-2018)

Shërbime postare të ofruara		Objekte postare 2017	Objekte postare 2018	Ndryshim 2018/2017
Posta Shqiptare sh.a				
1	Shërbim Universal Postar			
1.1	Postë brenda vendit	18,599,662	18,298,143	-1.6%
1.2	Postë ndërkombëtare	1,322,758	1,413,574	6.9%
1.3	Totali 1.1+1.2	19,922,420	19,711,717	-1.1%
2	Shërbim joniversal postar			
2.1	Postë brenda vendit	2,603,017	2,819,601	8.3%
2.2	Postë ndërkombëtare	9,702	6,616	-31.8%
2.3	Totali 2.1+2.2	2,612,719	2,826,217	8.2%
3	Shërbim ekspres			
3.1	Ekspres brenda vendit	724,794	699,731	-3.5%
3.2	Ekspres ndërkombëtar	25,764	18,842	-26.9%
3.3	Totali 3.1+3.2	750,558	718,573	-4.3%
Ofruesit e shërbimeve postare				
4	Shërbim JoUniversal Postar			
4.1	Postë brenda vendit	277,504	490,900	76.9%
4.2	Postë ndërkombëtare	34,632	35,486	2.5%
4.3	Totali 4.1+4.2	312,136	526,386	68.6%
5	Shërbim ekspres			
5.1	Ekspres brenda vendit	1,050,783	1,408,298	34.0%
5.2	Ekspres ndërkombëtar	206,705	222,725	7.8%
5.3	Totali 5.1+5.2	1,257,488	1,631,023	29.7%
6	Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	24,855,321	25,413,916	2.2%

Sipas të dhënave të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare për vitin 2018, disa nga treguesit kryesorë të shërbimeve postare, për ofrimin e katër shërbimeve në raport me popullsinë dhe sipërfaqen e Republikës së Shqipërisë rezultojnë të jenë:


- Objekte postare gjithsej **25,413,916** në raport me popullsinë (banorë rezident) 2.870.324 janë: **8.85 objekte / banorë**.
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun në raport me popullsinë 2.870.324 janë: **2,850 banorë / zyrë**.
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun në raport me sipërfaqen 28,748 Km² janë: **28.55 Km² / zyrë**.

2. Treguesit dhe evidenca e realizimit të Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

Posta Shqiptare ruan deri në vitin 2020 të drejtën si ofrues i vetëm i shërbimit universal postar. Volumin kryesor në shërbimin universal postar brenda vendit e zënë Objektet e thjeshta me 15,139,767 copë ose 83% të ndjekura nga Objektet e regjistruara me 3,158,376 copë ose 17%.


Në grafikët 1 dhe 2 të paraqitur me poshtë, jepen të dhënat lidhur me numrin e objekteve të shërbimit universal postar brenda vendit të pranuar nga Ofruesi i Shërbimit Universal gjatë vitit 2018, si dhe të dhënat krahasimore të këtyre shërbimeve në raport me vitet paraardhëse.

Grafiku 1-Shërbimi universal postar brenda vendit gjatë vitit 2018



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP.


Grafiku 2- Ecuria në vite e Shërbimit Universal postar brenda vendit



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP.

Nga të dhënat e grafikut 2 vihet re se në vitin 2018 ka një rënie prej 2% të numrit të objekteve postare brenda vendit krahasuar me 2017.


Grafiku 3- Shërbimi Univeral postar ndërkombëtar gjatë vitit 2018



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP.

Nga të dhënat e grafikut 3 vihet re se volumin kryesor në shërbimin universal postar ndërkombëtar për Objektet Postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit e zënë Objektet e regjistruara me 191,152 copë ose 57% të ndjekura nga Objektet e thjeshta me 143,544 copë ose 43%, ndërsa në Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri vendin kryesor e zënë Objektet e thjeshta me 694,975 copë ose 64% të ndjekura nga Objektet e regjistruara me 383,903 copë ose 36%.

Grafiku 4 - Ecuria në vite e Shërbimit Univeral postar ndërkombëtar




Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP.

Nga të dhënat e grafikut 4 vihet re se gjatë vitit 2018 Posta Shqiptare ka realizuar gjithsej 1,413,574 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

3. Treguesit e shërbimit jouniversal posta


Grafiku 5- Shërbimi jo-Universal Postar i P.SH brenda vendit gjatë vitit 2018



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e grafikut 5 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jouniversal postar brenda vendit për Postën Shqiptare e zënë Objektet e regjistruara me 2,724,379 copë ose 97% të ndjekura nga Objektet e thjeshta me 95,222 copë ose 3%.


Grafiku 6 - Shërbimi joUniversal Postar brenda vendit gjatë vitit 2018 për Ofruesit e tjerë



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e grafikut 6 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jouniversal postar brenda vendit për Operatorët e tjerë postar e zënë Objektet e thjeshta me 402,757 copë ose 82% të ndjekura nga Jo dokumenta Pako/Koli me 88,143 copë ose 18%.


Grafiku 7 - Shërbimi jo-Universal Postar brenda vendit P.SH.vs Ofruesit e Tjerë



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e grafikut 7 vihet re se Posta shqiptare mbulon 85% të shërbimit jouniversal postar brenda vendit me 2,819,601 objekte, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 15% me 490,900 objekte.

Grafiku 8 - Shërbimi joUniversal Postar Nërkombëtar P.SH gjatë vitit 2018




Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e grafikut 8 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jouniversal postar ndërkombëtar për Postën Shqiptare për Objektet postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit e zënë Objektet e regjistruara me 1,200 copë ose 83% të ndjekura nga Objektet e

thjeshta me 241 copë ose 17% , ndërsa për Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri ka vetëm Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta me 5,175 copë pra 100%.


Grafiku 9 - Shërbimi joUniversal Postar Nërkombëtar Ofruesit e tjerë gjatë vitit 2018



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e grafikut 9 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jouniversal postar ndërkombëtar për Operatorët e tjerë postar për Objektet postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit e zënë Jo dokumenta Pako/Koli me 5,783 copë ose 51% të ndjekura nga Objektet e korrespondencës me 5,644 copë ose 49% , ndërsa për Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri vendin kryesor e zënë Jo Dokumenta Pako/Koli me 13,136 copë ose 55% të ndjekura nga Objektet e korrespondencës me 10,923 copë ose 45%.


Grafiku 10 - Shërbimi jo-Universal Postar Nërkombëtar P.SH vs Ofruesit e tjerë



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e grafikut 10 vihet re se Posta shqiptare mbulon 16% të shërbimit jouniversal postar ndërkombëtar me 6,616 objekte, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 84% me 35,486 objekte.

Grafiku 11- Shërbimi jo-Universal Postar Kombëtar dhe Nërkkombëtar P.SH vs Ofruesit e tjerë gjatë vitit 2018




Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e grafikut 11 vihet re se Posta shqiptare mbulon 84% të shërbimit jouniversal postar (kombëtar dhe ndërkombëtar) me 2,826,217 objekte, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 16% me 526,386 objekte.

4. Treguesit e shërbimit Ekspres

“Shërbim ekspres” është shërbimi i shpërndarjes “derë me derë”, në një kohë të shkurtër, shpërndarjes një ditë pas dorëzimit, ose transportit në kohë të përcaktuar të objektit postar që përfshin shpërndarjen e dokumenteve, pakove dhe mallrave.

Grafiku 12 - Shërbimi Ekspres brenda vendit dhe ndërkombëtar i Postës Shqiptare gjatë vitit 2018




Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e grafikut 12 vihet re se 99.9% e shërbimit ekspres brenda vendit mbulohet nga Dokumenta ndërsa në shërbimin ekspres ndërkombëtar 83% e shërbimit mbulohet nga objekte

postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 17% nga objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.


Grafiku 13 - Posta Shqiptare - Shërbimi Ekspres kombëtar vs ndërkombëtar



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e grafikut 13 vihet re se për Postën Shqiptare 97% e shërbimit ekspres mbulohet nga shërbimi ekspres brenda vendit dhe vetëm 3 % nga shërbimi ekspres ndërkombëtar.

Grafiku 14 – P.SH – Ecuria në vite e Shërbimit Ekspres kombëtar dhe ndërkombëtar në total



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e grafikut 14 vihet re se për Postën Shqiptare gjatë vitit 2018 ka një rënie prej 4% të shërbimit ekspres në total (brenda vendit dhe ndërkombëtar).

Në vijim jepen në formë tabelare dhe grafike të dhënat statistikore për Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimet ekspres, me qëllim vlerësimin dhe krahasimin e tyre.


Tabela 2 - Shërbimi Ekspres Kombëtar dhe Ndërkombëtar për Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare

	Ekspres brenda vendit	Ekspres ndërkombëtar
<i>Albanian Delivery Exppress</i>	658,735	1,430
<i>Albanian Cargo Service</i>	15	21
<i>Albanian Courier</i>	467,745	30,365
<i>DHL</i>	24,079	131,758
<i>RAD MAIL</i>	0	0
<i>SKY NET LOGISYIC</i>	0	832
<i>TNT</i>	120,800	863
<i>FEDEX</i>	0	29,101
<i>United Transport</i>	267	28,355
<i>YAPS</i>	136,652	0
<i>FAST - DELIVERY</i>	0	0
<i>E-Komplet</i>	5	0
<i>COEX</i>	0	0
<i>Albanian Parcel Distribution</i>	0	0
Totali	1,408,298	222,725

Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e tabelës 2 rezulton se për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ekspres, treguesin më të mirë për shërbimin brenda vendit e ka Albanian Courier me 467,745 objekte. Për sa i përket shërbimit ekspres ndërkombëtar treguesin më të mirë i ka DHL me 131,758 objekte, Albanian Courier me 30,365 objekte e ndjekur nga FEDEX me 29,101 objekte.


Grafiku 15- Shërbimi ekspres Kombëtar vs Ndërkombëtar për Ofruesit e tjerë gjatë vitit 2018



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Në grafikun 15 është paraqitur mbulimi i tregut postar nga ofruesit e tjerë të shërbimeve postare të ndara në shërbim ekspres brenda vendit dhe shërbim ekspres ndërkombëtar.


Grafiku 16 – Shërbimi Jouniversal Postar dhe Shërbimi ekspres për operatorët e tjerë gjatë vitit 2018



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP


Nga të dhënat e grafikut 16 rezulton se gjatë vitit 2018 operatorët e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar 1,631,023 objekte postare që i përkasin shërbimit ekspres ose 76% të totalit dhe 526,386 objekte postare që i përkasin shërbimit jouniversal ose 24% të totalit.

Grafiku 17- Shërbimi ekspres në total – P.SH vs Ofruesit e tjerë



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP


Grafiku 18 - Shërbimi ekspres në total – P.SH vs Ofruesit e tjerë



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e grafikëve 17 dhe 18, duke krahasuar shërbimin ekspres në total të Postës Shqiptare me shërbimin ekspres në total të Ofruesve të tjerë të shërbimeve postare rezulton se Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 69% të tregut ekspres me 1,631,023 objekte postare dhe Posta Shqiptare 31% me 718,573 objekte postare.


Grafiku 19 – Totali i objekteve postare – P.SH. vs Ofruesit e tjerë



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e grafikut 19 vihet re se gjatë vitit 2018 Posta Shqiptare ka realizuar 23,256,507 objekte postare në total ose 92% kundrejt 2,157,409 objekte postare në total për gjithë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare në total ose 8%.

Grafiku 20 – Ecuria në vite e totalit të objekteve postare për P.SH dhe Ofruesit e tjerë



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e grafikut 20 vihet re se gjatë vitit 2018 ka pasur një rritje prej 558,595 objekte postare ose 2% krahasuar me vitin 2017.

5. Treguesit teknik të rrjetit postar

Posta Shqiptare e cila ofron shërbim në të gjithë vendin në **563** zyra të hapura për publikun ka treguesit më të mirë të rrjetit, e ndjekur nga Albanian Courier, Albanian Cargo Service, United Transport, Albanian Delivery Express, TNT etj.

Posta Shqiptare ka vënë në dispozicion të publikut për ofrimin e shërbimit universal **700** sportele nga të cilët **521** sportele janë të automatizuar/kompjuterizuar.

Për pranimin e objekteve postare ka vënë në dispozicion të përdoruesve **537** kuti postare dhe për dorëzimin e objekteve postare **667** kuti postare, gjithësej **1,204** kuti postare.

Në përgjithësi prezenca e zyrave postare të ofruesve të tjerë, përveç Postës Shqiptare, është në qytetet kryesore të vendit.

Përsa i përket infrastrukturës së mjeteve postare, Posta Shqiptare ka në përdorim **416** mjete transporti, Albania Courier **41**, Albanian Delivery Express **43**, FEDEX **64**, TNT **25**, të pasuar nga Ofruesit e tjerë.


Në mjetet e transportit përfshihen kamiona, furgona, vetura, motocikleta dhe bicikleta.

Tabela 3- Treguesit Teknik të rrjetit – P.SH dhe Ofruesit e Tjerë

	Zyra postare të hapura për publikun	Zyra postare jo të hapura për publikun (qendra përpunimi)	Numri i automjeteve të transportit	Numri i sporteleve për shërbime Universale	Kuti postare
Posta Shqiptare	563	37	416	700	1204
Albanian Delivery Express	51	1	43		
Albanian Cargo Service	103	2	3		
Albanian Courier	104	2	41		
DHL	22	1	12		
RAD MAIL	1	0	8		
SKY NET LOGISYIC	9	2	5		
TNT	34	1	25		
FEDEX	13	1	64		
United Transport	102	1	6		
YAPS	1	1	10		
FAST - DELIVERY	1		0		
E-Komplet	1	0	7		
COEX	1	0	9		
Albanian Parcel Distribution	1	0	0		
Total	1,007	49	649	700	1,204

Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Grafiku 21 - Treguesit Teknik të rrjetit – Posta SHqiptare viti 2018



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

6. Cilësia dhe standartet e shërbimit postar

Standartet për cilësinë e shërbimit universal postar, përcaktohen me rregullore nga AKEP për të garantuar ofrimin e shërbimit me cilësi të mirë, sipas standardeve ndërkombëtare. Cilësia e shërbimit përfshin, në veçanti, kërkesa për kohën e shpërndarjes së objekteve postare, sistemin e informimit për ndjekjen e objekteve postare, rregullsinë dhe besueshmërinë e shërbimeve kombëtare dhe ato ndërkufitare/ndërkombëtare

Tabela 4- Standartet e cilësisë së Shërbimit Universal Postar gjatë vitit 2018

Postë brenda vendit							Postë ndërkombëtare					
Brenda për brenda qytetit		Ndërmjet qyteteve		Në fshatra			Vendet e BE (Europë)			Vendet e tjera (UPU)		
D+1	D+2	D+1	D+2	D+2	D+3	D+4	D+3	D+5	D>5	D+5	D>5	
96.3	3.7%	95.2%	4.8%	77.7%	20.0%	2.3%	85.1%	97.3%	100%	0%	0%	

Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Tabela 5- Standartet e cilësisë së Shërbimit Ekspres Kombëtar dhe Ndërkombëtar gjatë vitit 2018

	Postë brenda vendit			Postë ndërkombëtare		
	D+1	D+2	D>2	D+1	D+2	D>2
<i>Albanian Delivery Express</i>	95	3	2	95	3	2
<i>Albanian Cargo Service</i>	95	5	0	85	15	0


Albanian Courier	95	5	0	85	15	0
DHL	99	1	0	93.4	5.3	1.3
RAD MAIL						
SKY NET LOGISYIC	0	0	0	0	0	100
TNT	47	12	41	40	28	32
FEDEX	60	30	10	70	20	10
United Transport	99	1	0	40	60	0
YAPS	75	0	25	0	0	0
FAST - DELIVERY						
E-Komplet	97	3	0	0	0	0
COEX						
Albanian Parcel Distribution						

Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

7. Të punësuarit


Në funksion të volumit të punës Posta Shqiptare ka 2,400 të punësuar, FEDEX ka 75 të punësuar, Albanian delivery Express dhe TNT kanë 68, Albania Courier 64, DHL 55, të ndjekur nga subjektet e tjerë sipas shifrave që paraqiten në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 22- Numri i të punësuarve nga Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare në vitin 2018



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP


Grafiku 23- Numri i të punësuarve në total nga P.SH dhe Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga të dhënat e grafikut 23 duket qartë se Posta Shqiptare mbulon 85% të tregut postar të të punësuarve në total kundrejt 15% të ofruesve të tjerë së bashku.

Grafiku 24- Ecuria e numrit të të punësuarve në harkun kohor 2012-2018




Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

8. Ankesat


Sipas të dhënave të dërguara, gjatë vitit 2018 pranë Posta Shqiptare janë depozituar 1,315 reklamacione nga të cilat janë zgjidhur 920, pranë DHL janë depozituar 52 reklamacione nga të cilat janë zgjidhur plotësisht, United Transport kanë regjistruar 5 nga të cilat kanë zgjidhur 5 reklamacione, Rad Mail kanë regjistruar 8 nga të cilat kanë zgjidhur 8 reklamacione ndërsa E-Komplet kanë pranuar 4 reklamacione nga të cilat janë zgjidhur 4.

Grafiku 25 – Ankesat e rregjtruara gjatë vitit 2018



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Grafiku 26- Ecuria e numrit të ankesave në harkun kohor 2012-2018



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga krahasimi i ankesave (reklamacioneve) të pranuar, gjatë vitit 2018 vërehet një rritje me rreth 18% të ankesave per ofruesin e shërbimit universal dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare në krahasim me vitin 2017, gjithashtu nga krahasimi i ankesave (reklamacioneve) të zgjidhura gjatë vitit 2018 vërehet një rritje me rreth 30 % të ankesave nga ofruesi i shërbimit universal dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare në krahasim me vitin 2017.


9. Rezultatet financiare

Bazuar në të dhënat e raportuara për vitin 2018 nga ofruesi i shërbimit universal postar dhe ofruesit e shërbimeve postare, të ardhurat financiare në tregun postar rezultojnë të jenë 2,138,499,881 Lekë. Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash 1,403,396,147 Lekë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar të ardhura në total 735,103,734 Lekë. Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve të tregut postar bazuar në të ardhurat për vitin 2018. Posta Shqiptare zotëron 66% të tregut, e pasuar nga DHL Albania me 9% të tregut dhe më pas nga FEDEX me 6% dhe me pas ofruesit e tjerë. Të ardhurat nga shërbimet postare për vitin 2016 janë ulur me 4% në krahasim me vitin 2017.

Tabela 6 - Të ardhurat në sektorin postar Viti 2018

Subjekti	Totali i të ardhurave nga shërbimet postare (/000 Lekë)
Posta Shqiptare	1,403,396
Ofrues të shërbimeve postare	735,103
Totali	2,138,500

Grafiku 27 - Pjesë tregu në të ardhura




Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Tabela 7 - Posta Shqiptare - Të ardhura në vitin 2018 sipas shërbimeve (/000 Lekë)

Të ardhurat nga shërbimet postare	1,403,396
Shërbimi postar universal	1,173,414
Shërbimi postar jo universal	25,952
Shërbimi postar ekspres	204,030

Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Grafiku 28 - Posta Shqiptare - Pjesë tregu të ardhura sipas shërbimeve




Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Tabela 8 - Të ardhura dhe investime në harkun kohor 2012-2018 (/000 Lekë)

Viti	Të ardhura	Investime
2012	1,769,967	135,656
2013	1,671,825	46,295
2014	1,879,102	141,185
2015	2,086,313	135,696
2016	2,079,437	227,661
2017	2,237,231	251,457
2018	2,138,500	193,342

Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Grafiku 29 - Ecuria e të ardhurave dhe investimeve në harkun kohor 2012-2018




Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Tabela 9 - Rezultati Neto nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare (/000 Lekë)

Posta Shqiptare	42,795
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare	74,162
Totali	116,957

Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Grafiku 29 - Rezultati Neto nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë vitit 2018



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit në AKEP

Nga grafiku i mësipërm vihet re se Posta Shqiptare mbulon 37% të totalit të fitimit nga shërbimet postare kundrejt 63% të mbuluar së bashku nga ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.